



01/Nr. 9555/2024
Data : 11.12.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 19.11.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkyetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë , Rini dhe Sport), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i auditimit nga divizioni i auditimit të brendshëm – MFPT.
3. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për draft planin zhvillimorë të komunës së Hanit të Elezit 2024-2032.
4. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.
5. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- kërkoj që pika e tretë e rendit të punës të prolongohet për muajin dhjetorë për shkak se ende nuk e kemi marr pëlqimin prej Ministrisë edhe pse kemi pritur këto ditë por deri më sot nuk na është dërguar.

Sherif Berisha thekson:-në mbledhjen e fundit të kuvendit kemi diskutuar për normat e tatimit në pronë dhe kemi kërkuar që të informohemi me material shtesë por ende nuk kemi pranuar .

Kryesuesi thekson:- për propozim vendimin për normat tatimore në KPF është diskutuar dhe ka kaluar kjo pikë për kuvendë por edhe në mbledhje të kuvendit është diskutuar dhe u dakorduar që me bërë komision për me i zbritur normat tatimore. Kjo pikë e rendit të punës do të përcillet për kuvendë. Propozimin e z. Nexhmedin Daci e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Raporti i auditimit nga divizioni i auditimit të brendshëm – MFPT.**
3. **Plani i veprimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.**
4. **Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i auditimit nga divizioni i auditimit të brendshëm – MFPT.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në mungesë të auditorit të brendshëm në komunën tonë ne kemi kërkuar me marr shërbim nga divizioni i auditimit të brendshëm nga Ministria e financave punës dhe transfereve dhe ato e kanë auditura komunën tonë dhe ky auditim ka rezultuar me katër të gjetura. E gjetura e parë ka të bëjë që komuna të merr masat e duhura në përputhje me kornizën ligjore në fuqi që të funksionalizoj, harmonizojë dhe të përshtatë strukturën organizative dhe rregulloren me funksionet dhe nevojat për kryerjen e detyrave në arritjen e objektivave dhe misionit. E gjetura e dytë ka të bëjë që komuna duhet të sigurojë planifikim dhe menaxhim të mirë të buxhetit me një analizë, vlerësim më adekuat të nevojave në harmoni me kodet ekonomike me qëllim të pasqyrimit të saktë për të gjitha shpenzimet sipas rregullave financiare . E gjetura e tretë është që të bëhet regjistrimi , kompletimi të gjitha lëndëve për shpenzimet e realizuara dhe mbyllja e obligimeve në afatin kohorë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Të përgatitet rregullorja e brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare sipas rregullores Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatën buxhetore.

Hyriete Isufi thekson:- auditimi i brendshëm me atë që e patëm më herët a kanë diçka të përbashkët .

Lindita Ballazhi thekson:- kanë të përbashkëta disa të gjetura , e gjetur e përbashkët është ekzekutimi i obligimeve jo financiare që ne si komunë kemi pasur vonesa në ekzekutimin e obligimeve financiare, pra është një e gjetur që e ka gjetur edhe zyra kombëtare e auditimit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I AUDITIMIT NGA DIVIZIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM -MFPT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket planit të veprimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm, në material janë të shënuara aktivitete që do të ndërmerren nga menaxhmenti.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I VEPRIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- sa i përket informatës me fokus të veçantë është muaji tetor ku kemi pasur aktivitete me ngritjen e vetëdijesimit të gratë për sëmundjen e kancerit të gjirit, hapjen e fushatës e kemi filluar me marrshi nëpër qytet për kancerin e gjirit, kemi pasur ekskursion me gratë e prekura me kancer, shfaqjen teatrale fustani rozë, kemi pasur radiologun që për gjatë muajit tetor që për çdo të mërkure ka ofruar shërbime për të gjitha gratë e komunitetit. Me datë katërmëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë tetor përmes Ministrisë së Shëndetësisë i kemi mundësuar që përmes mamografisë të ekzaminohen njëzetë e katër gra të komunës sonë falas . Përveç materialeve të cilat i kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- a keni numër të saktë të personave të diagnostikuar me kancer më herët dhe sa është numri i personave të diagnostikuar me kancer në komunën tonë.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:-jam te përgatitur një shkresë dhe do ti drejtohem departamentit të onkologjisë që me pasur numrin e saktë të qytetarëve tonë se sa janë të prekur me kancer.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI GJENDJEN NË SHËNDETËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- janë hapur disa gropa rrugës për në Fshatin Seçishtë dhe kërkoj informacion të dijë se a ka ndonjë pëlqim që janë hapur ato gropa. Te rruga e fshatit Dimcë rrjedh uji dhe askush nuk është marr me këtë çështje. Te rruga e fshatit Dimcë janë disa prona që janë shpronësuar dhe përsëri zihen me tela pra pengohen për autoudhën dhe në disa pjesë i lejoni e në disa nuk i lejoni për me i shfrytëzuar ato prona. Qytetarët ma kanë paraqitur si shqetësim shenjën te rrethi që është shumë e shkurtë edhe pse nuk është në kompetencë të komunës është mirë me rregulluar.

Xhevahir Dernjani thekson:-a janë ekzekutuar mjetet shtesë financiare të mësimdhënëseve për te shkolla e mesme "Dardania" . Për nderë të datës njëzet e tetë nëntor drejtorja e kulturës a ka përgatitur ndonjë program për nderë të kësaj date. Te drejtorja e urbanizmit të gjitha projektet janë në përfundim e sipër por kur do të jetë faza përfundimtare te parku "Bllaca 99" , te zona e Paldenicës dhe projekti i rrugës ka fabrika , projekti i rrugës "Nehat Curri".

Sevdi Dernjani thekson:-sa i përket informacioneve që i kërkoj z.Sherif Berisha besoj që drejtoria përgjegjëse për mbledhje të kuvendit do të jep sqarime.

Lindita Ballazhi thekson:- është muaji i dytë që i kemi përcjellë në thesarë për ekzekutim edhe të sektorit të shëndetësisë dhe të arsimit por nuk janë ekzekutuar nga thesari për shkak se ne për çdo muaj i përcjellim ndryshimet.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket shpronësimeve nuk jam në dioni dhe nuk kemi pasur ndonjë kërkesë. Projektet kapitale të cilat u përmendën më lartë shpresojë se këto ditë do të përfundojnë.

Arbenita Bajramaliu thekson:- për nderë të festës së njëzet e tetë nëntorit nga nesër do të fillojnë përgatitjet për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:39.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

